

SË SHPEJTI NJË LIGJ I RI PËR KOOPERATIVAT BUJQËSORE

Ftohen anëtarët e KASH-it, në mënyrë të veçantë shoqatat e fermerëve dhe shoqëritë e bashkëpunimit reciprok të japin sugjerime dhe komente lidhur me këtë projekt-ligj

PROJEKTLIGJ PËR SHOQËRITË KOOPERATIVISTE BUJQËSORE

Neni 1 Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe kushteve për krijimin, funksionimin dhe shpërndarjen e shoqërisë kooperativiste bujqësore.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për shoqëritë kooperativiste bujqësore që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3 Shoqëria Kooperativiste bujqësore

Shoqëria kooperativiste bujqësore është bashkim vullnetar i personave fizikë ose juridikë për kryerjen e veprimeve ekonomike në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, ofrimin e shërbimeve që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin bujqësor e blegtoral si dhe realizimin e aktiviteteve që synojnë promovimin dhe përmirësimin e zonave rurale.

KREU II

VEPRIMTARIA E SHOQËRISË KOOPERATIVISTE BUJQËSORE

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria kooperativiste bujqësore, përveç sa parashikohet në statut, ka në objekt të veprimtarisë së saj edhe kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

a) blerje, përpunim, prodhim dhe fabrikim të çfarëdolloj forme të: koncentrateve, plehrave kimike, bimëve, farërave, produkteve fitosanitare, materialeve, instrumenteve, makinerive, pajisjeve, kafshëve apo elementeve të tjerë, të nevojshëm për nxitjen dhe zhvillimin e prodhimit bujqësor dhe blegtoral;

b) konservim, standartizim, manipulim, transformim, transport, shpërndarje dhe shitje, të prodhimeve të freskëta apo pjesërisht të transformuara më parë;

c) blerje, sistemim, drenazhim dhe përmirësim të tokave të destinuara për qëllime bujqësore dhe blegtorale;

ç) çdo lloj aktiviteti tjetër të nevojshëm që favorizon dhe lehtëson përmirësimin ekonomik, teknik, ekologjik dhe të kushteve të punës të shoqërisë kooperativiste bujqësore;

d) realizim të aktiviteteve të konsumit dhe të shërbimeve për anëtarët dhe shoqëritë e tjera kooperativiste bujqësore;

dh) Ofron mundësi edukimi, formimi profesional dhe promovimi për anëtarët e saj, për anëtarët e organeve, për të punësuarit, në mënyrë që këta të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë kooperativiste bujqësore;

e) informim i publikut mbi natyrën dhe përfitimet që sjell bashkëpunimi.

Neni 5 Selia

Selia e shoqërisë kooperativiste bujqësore përcaktohet në statut, kryesisht, në zonën ku kryen veprimtarinë ose ku ka të përqendruar aktivitetin drejtues.

Neni 6 Territori

Shoqëria kooperativiste bujqësore ka territorin e saj përkatës, shtrirja e të cilit përcaktohet në statutin e shoqërisë. Në asnjë rast nuk mund të ketë mbivendosje të territorit midis dy ose me shumë shoqërive kooperativiste bujqësore.

Neni 7 Emërtimi

1. Shoqëria kooperativiste bujqësore ka emërtimin e saj që caktohet në statut.

2. Në shkresat, publikimet dhe të gjitha dokumentet e shoqërisë emërtimi i saj duhet të paraprihet nga fjalët "Shoqëria kooperativiste bujqësore", pas të cilave shënohet emri i saj dhe numri i regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 8 Veprime me të tretët

Shoqëria kooperativiste bujqësore realizon aktivitetin dhe shërbimet me të tretët deri në 50% të kapitalit total, kur parashikohet në statut dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 9 Seksionet

Shoqëria kooperativiste bujqësore ka të drejtë të krijojë seksione, sipas natyrës specifike të aktiviteteve që kryen për realizimin e veprimtarisë së saj. Rregullat për krijimin dhe funksionimin e seksioneve parashikohen në statut.

KREU III

REGJISTRIMI, KLASIFIKIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË KOOPERATIVISTE BUJQËSORE

Neni 10 Regjistrimi

1. Shoqëria kooperativiste bujqësore e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Regjistrimi kryhet pas depozitimit të kërkesës, të shoqëruar me aktin e themelimit dhe me statutin e shoqërisë kooperativiste bujqësore bujqësore, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 11 Klasifikimi i shoqërive kooperativiste bujqësore

Shoqëritë kooperativiste bujqësore klasifikohen në dy nivele:

- a) shoqëri kooperativiste bujqësore të nivelit të parë, e cila përbëhet nga 10 anetarë dhe
- b) shoqëri kooperativiste bujqësore të nivelit të dytë, e cila përbëhet nga të paktën dy shoqëri kooperativiste bujqësore të nivelit të parë.

Neni 12 Akti i themelimit

Akti i themelimit të shoqërisë kooperativiste bujqësore nënshkruhet nga të gjithë nismëtarët dhe përmban elementët e mëposhtëm:

- a) identitetin e nismëtarëve dhe të përfaqësve të organeve drejtuese të shoqërisë,
- b) deklaratën e përbushjes së kriterëve për të qenë anetarë,
- c) vërtetimin e dredhjes së kontributit të detyrueshëm minimal në kapitalin e shoqërisë.

Neni 13 Statuti

1. Statuti i shoqërisë kooperativiste bujqësore përmban këto elementë:

- a) emërtimin,
 - b) objektin e veprimtarisë,
 - c) selinë,
 - ç) shtrirjen territoriale të veprimtarisë,
 - d) afatin e veprimtarisë,
 - dh) kapitalin minimal të shoqërisë
 - e) kontributin e detyrueshëm, minimal, formën dhe afatet e derdhjes në kapitalin e shoqërisë, që duhet të realizohet për të qenë anetar,
 - ë) tipet e anetarëve, kriteret për pranimin e tyre, kushtet për dorëheqjen vullnetare dhe të detyrueshme, si dhe regjimin e zbatueshëm,
 - f) të drejtat dhe detyrat e anetarëve,
 - g) të drejtën për rimbursim të kontributeve të anetarëve, si edhe regjimin e kalimit të tyre,
 - gj) normat e disiplinës, shkeljet dhe sanksionet, procedurën sanksionuese dhe humbjen e pozitës së anetarit.
 - h) përbërjen, numrin dhe mandatin e zgjedhjes së anetarëve të organeve drejtuese të shoqërisë,
 - i) rregullimin e seksioneve, nëse ka.
2. Çdo ndryshim i statutit depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU IV

ANETARET E SHOQËRISË KOOPERATIVISTE BUJQËSORE

Neni 14 Anetaret e shoqërisë kooperativiste bujqësore

1. Anetaret e shoqërisë kooperativiste bujqësore ndahen në:

- a) Anetarë me të drejta të plota,
- b) Anetarë bashkëpunëtorë,
- c) Anetarë pune.

2. Të drejtat dhe detyrat e anetarëve përcaktohen në statutin e shoqërisë kooperativiste bujqësore.

Neni 15 Anetarë me të drejta të plota

Anetarë me të drejta të plota janë fermerë që përftojnë më shumë se 50% të të ardhurave të tyre nga bujqësia dhe blegtoria dhe që i kushtojnë të paktën 50% të kohës për punë fermës.

Neni 16 Anetaret bashkëpunëtorë

1. Anetarë bashkëpunëtorë janë fermerë që përftojnë më pak se 50% të të ardhurave të tyre nga bujqësia dhe blegtoria dhe që i kushtojnë më pak se 50% të kohës për punë fermës bujqësore dhe blegtorale.

2. Kontributet e dhëna nga anetaret bashkëpunëtorë në asnjë rast nuk mund të kalojnë 45% të totalit të kontributeve në kapitalin e shoqërisë.

Neni 17 Pranimi i anetarëve të rinj

1. Kërkesa për pranimin e anetarit, bëhet me shkrim dhe depozitohet pranë Këshillit Drejtues, i cili shprehet me vendim të motivuar brenda 30 ditëve. Vendimi i Këshillit Drejtues i njoftohet kërkuarit brenda 5 ditëve, sipas mënyrës së përcaktuar në statut. Nëse Këshilli Drejtues nuk shprehet lidhur me kërkesën e depozituar, brenda afatit të parashikuar, kërkesa konsiderohet e pranuar.

2. Në rast se kërkesa refuzohet, kërkuari ka të drejtën e paraqitjes së ankimit pranë Komitetit të Apelit, ose në mungesë të tij, pranë Asamblesë së Përgjithshme, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Komiteti i Apeliteve, brenda 20 ditëve shqyrton ankesën dhe vendimin e marrë e përcjell për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme shprehet me vendim mbi shqyrtimin e ankesës dhe sipas rasti mbi vendimin e marrë nga Komiteti i Apelit, jo më vonë se dy mbledhje të njëpasnjëshme.

3. Pranimi i anetarit të ri shoqërohet me regjistrimin në aktin e themelimit, me pagesën e kuotës së hyrjes dhe derdhjen e kontributit të detyrueshëm në kapitalin shoqëror, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 18 Të drejtat e anetarëve

1. Të drejtat e anetarëve përcaktohen në këtë ligj dhe në statutin e shoqërisë kooperativiste bujqësore.
2. Sipas këtij ligji anetarët kanë këto të drejta:
 - a) të propozojë ndryshime në përbërjen e organeve drejtuese të shoqërisë,
 - b) të propozojë ndryshime apo përmirësime të statutit apo të akteve që kanë lidhje me regjimin e brendshëm të shoqërisë,
 - c) të zgjedhë ose të zgjidhet në postet e larta të organeve drejtuese të shoqërisë,
 - ç) të kërkojë dhe të disponojë kopje të statutit, të rregullores së brendshme apo të vendimeve të organeve drejtuese të shoqërisë, kryesisht, kur preken interesat e tij,
 - d) të kërkojë dhe të marrë të dhëna në lidhje me situatën financiare dhe ekonomike të situatës së tij brenda shoqërisë,
 - dh) të informohet, sa herë që depoziton kërkesë me shkrim, lidhur me gjendjen financiare të shoqërisë, kryesisht për: llogaritë vjetore financiare, raportin e menaxhimit, mënyrën dhe procedurat e shpërndarjes së fitimit dhe dividendit, të raporteve të specialistëve kontabël ose raportin e auditit,
 - e) të informohet rregullisht mbi mbledhjet që zhvillohen të organeve drejtuese, duke përfshirë në informacionin e dhënë: pikat e rendit, dokumentacionin e përgatitur për mbledhje, si dhe të dhëna të tjera, të cilat lidhen me vendimmarjen mbi një çështje të caktuar e cila mund të prekë interesat e tij.
3. Nëse në statut nuk parashikohet ndryshe, Këshilli Drejtues, informon me shkrim anëtarin mbi çështjet e trajtuara në kërkesën e tij, brenda 30 ditëve nga paraqitja e saj.
4. Çështjet të cilat kanë lidhje me rregullimet statutore, përcaktimet e akteve themeluese, kushtet e regjistrimit apo mënyrën e drejtimit të shoqërisë, dhe çështje të tjera të cilat trajtohen në kërkesën e më shumë se 10% të anetarëve të shoqërisë kooperativiste bujqësore, përfshihen për shqyrtim dhe diskutim në rendin e ditës së mbledhjes më të parë të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Në rastet e parashikuara në shkronja "dh" e "e" të pikës 2 të këtij neni, Këshilli Drejtues mund të refuzojë dhënien e informacionit të kërkuar, kur ka arsye të dyshojë se:
 - a) informimi mund të vërë në rrezik interesat legjitime të shoqërisë kooperativiste bujqësore ose të anetarëve të tjerë,
 - b) kërkesa përbën një pengesë të përsëritur ose abuzim të qarte nga ana e anetarëve kërkuar.
6. Anetari kërkuar ka të drejtë të kundërshtojë refuzimin e dhënies së informacionit në përputhje me procedurën e parashikuar në këtë ligj.

Neni 19 Largimi i anetarit

1. Anetari mund të largohet nga shoqëria kooperativiste bujqësore:
 - a) vullnetarisht,
 - b) i detyruar.
2. Këshilli Drejtues shprehet me vendim të motivuar për largimin e anetarit, për secilin prej rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, dhe vendimin e marrë ja përcjell për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 20 Largimi vullnetar i anetarit

1. Anetari mund të largohet nga shoqëria kooperativiste bujqësore vullnetarisht, nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim të cilin ja drejton Këshillit Drejtues. Nëse në statut nuk parashikohet ndryshe, afati i njoftimit paraprak nuk mund të jetë më tepër se një vit dhe mosrespektimi i tij sjell si pasojë dëmshpërblimin përkatës.
2. Këshilli Drejtues vlerëson pasojat e largimit dhe përcakton mënyrën dhe masën e shlyrjes së dëmit të shkaktuar, brenda 60 ditëve nga depozitimi i kërkesës për largim, në rast se në statut nuk parashikohet ndryshe. Nëse Këshilli Drejtues nuk shprehet brenda afatit të parashikuar në këtë dispozitë apo në statutin e shoqërisë, largimi i anetarit konsiderohet i justifikuar për efekt të likuidimit të tij dhe rimbursimit të kontributeve në kapital.
3. Statutet mund të parashikojnë një klauzolë mbi kompromisin e anetarit për të mos u larguar vullnetarisht deri në përmbushjen e një afati të caktuar, i cili mund të lidhet me fundin e bilancit ekonomik ose deri kur të mbushë më shumë se pesë vjet si anetar në shoqërinë kooperativiste bujqësore.

Neni 21 Rastet e perjashtimit të anetarit

1. Anetari mund të perjashtohet nga shoqëria kooperativiste bujqësore me vendim të keshillit drejtues, në rastin kur:
 - a) nuk ka qenë i pranishëm në mbledhjet e organeve drejtuese më tepër se 80% të rasteve, pa motiv të justifikuar;
 - c) është në mënyrë permanente i papajtuashëm me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
 - b) ka humbur kriteret për të qenë anetar.
2. Vendimi i largimit, së bashku me masën e dëmshpërblimit përkatës i njoftohet anetarit të larguar brenda 5 ditëve nga marrja e tij.
3. Anetari ka të drejtë të kundërshtojë vendimin për largim, duke depozituar kërkesën për shqyrtim pranë Komitetit të Apelit, dhe në mungesë të tij pranë Asamblesë së Përgjithshme, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të largimit.

Neni 22 Masat disiplinore

Shkelja e dispozitave të këtij ligji apo të statutit të shoqërisë, nga njëri prej anetarëve të shoqërisë kooperativiste bujqësore, përbën shkak për nisjen dhe marrjen e masave disiplinore. Llojet e masave disiplinore dhe procedura e dhënies së tyre përcaktohen në statutin e shoqërisë. Masa më e rëndë disiplinore është përjashtimi nga shoqëria kooperativiste bujqësore.

KREU V

ORGANIZIMI I SHOQËRISË KOOPERATIVISTE BUJQËSORE

Neni 23 Organet e shoqërisë kooperativiste bujqësore

1. Organet e shoqërisë kooperativiste bujqësore janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme,

- b) Këshilli Drejtues,
 - c) Këshilli Mbikqyrës,
2. Statuti mund të parashikojë krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Apelit.

Neni 24 Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organ vendimarrës dhe përbëhet nga të gjithë anetarët e shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme, përveç sa parashikohet në statut, ka këto detyra:
 - a) vendos drejtimin e politikave ekonomike të shoqërisë kooperativiste bujqësore,
 - b) analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë: llogaritë vjetore, shpërndarjen e tepricave, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe çështje të tjera të veprimtarisë ekonomike që çmohen të rëndësishme,
 - c) emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues, Mbikqyrës, audituesit e llogarive likujduesit dhe sipas rastit, emëron dhe shkarkon anëtarët e Komitetit të Apeliteve
 - ç) përcakton masën e shpërblimeve për likujduesit,
 - d) miraton ndryshime të statutit,
 - dh) miraton kuotat e detyrimeve dhe të kapitalit të shoqërisë për anetarët.
 - e) përcakton normën e interesit që paguhet për derdhjet e detyrueshme dhe vullnetare në kapitalin e shoqërisë, nga anetarët e rinj dhe të atyre ekzistues,
 - ë) miraton shlyerjen e detyrimeve dhe titujve të pjesëmarrjes,
 - f) vendos shkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e shoqërisë,
 - g) vendos për ndryshimet e strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë,
 - gj) vendos për kalimin e shoqërisë në nivelin e dytë apo përfshirjen në to nëse janë krijuar.
 - h) vendos për pjesëmarrjen në forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik, aderim në organizata me karakter përfaqësues dhe shkëputjen prej tyre,
 - i) miraton raportet e kontrollit të ushtruar mbi angazhimin e anetarëve të Këshillit Drejtues, audituesve të llogarive dhe likujduesve.
 - j) miraton pranimin e anetarëve të rinj dhe largimin e atyre ekzistues.
3. Për çështjet që shqyrton, Asambleja e Përgjithshme merr vendimet përkatëse, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë anetarët e shoqërisë.

Neni 25 Format e Asamblesë së Përgjithshme

Në përputhje me specifikat e ushtrimit të detyrave të parashikuara në këtë ligj dhe në statutin e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme organizohet në dy forma:

- a) e zakonshme kur shqyrton raportin e gjendjes financiare të shoqërisë, raportin e veprimtarisë së Këshillit Drejtues dhe të gjitha çështjet e tjera të veprimtarisë ekonomike e të drejtimit që janë në kompetencat e saj.
- b) e jashtëzakonshme në rastet kur paraqitet nevoja që të vendosë për ndryshimin e statutit, për prishjen e shoqërisë, ndarjen, transformimin e shoqërisë në një formë tjetër, për kalimin e shoqërisë në nivelin e dytë.

Neni 26 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme e zakonshme thirret nga Këshilli Drejtues, brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit ekonomik.
2. Nëse brenda këtij afati nuk bëhet thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Këshillit Mbikqyrës duhet t'i drejtohen Këshillit Drejtues, dhe nëse ky i fundit nuk e thërret brenda 15 ditëve që nga marrja e kërkesës, atëherë i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor për ta thirrur. Pas mbarimit të afatit ligjor për thirrjen e Asamblesë së zakonshme, të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e ka çdo anetar. Në çdo rast gjykata shqyrton kërkesën e parë për thirrje që i paraqitet.
3. Asambleja e Përgjithshme e jashtëzakonshme thirret me kërkesë të Këshillit Drejtues, apo nga një numër anetarësh që përfaqëson të paktën 20% të totalit të votave, dhe nëse është e parashikuar në Statut, me kërkesë të antarëve të Këshillit Mbikqyrës. Nëse kërkesa nuk merret parasysh nga Këshilli Drejtues brenda 30 ditëve, kërkuessit kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor për ta thirrur.
4. Kur gjykata realizon thirrjen, atëherë ajo cakton personat që do të kryejnë funksionet e Presidentit dhe Sekretarit të Asamblesë.

Neni 27 Njoftimi për mbledhje

1. Asambleja e Përgjithshme njoftohet minimalisht 15 ditë dhe maksimalisht 30 ditë para mbledhjes, me anë të një njoftimi publik të vendosur në formë të dukshme në selinë e shoqërisë kooperativiste bujqësore, dhe në të gjitha qendrat e tjera ku kryehet aktiviteti i saj.
2. Njoftimi përmban datën, orën, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës. Procedura e njoftimit përcaktohet në statutin e shoqërisë.
3. Rendi i ditës caktohet nga Këshilli Drejtues dhe përfshin çështje të propozuara nga anetarët e Këshillit Mbikqyrës dhe nga të paktën 10% të numrit të anetarëve.

Neni 28 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Nëse në statut nuk parashikohet ndryshe, Asambleja e Përgjithshme mblidhet kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar më shumë se gjysma e anetarëve me të drejtë vote, dhe në një njoftim të dytë kur janë të pranishëm jo më pak se 30% e tyre. Asambleja njoftohet për herë të dytë jo më vonë se 5 ditë nga data e caktuar për zhvillimin e mbledhjes së parë.
2. Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga Presidenti, në mungesë të tij nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe në rolin e Sekretarit do të jetë Sekretari i Këshillit Drejtues ose ai që e zëvendëson me Statut. Në mungesë të tyre do të jenë të përzgjedhurit e Asamblesë.
3. Votimi është i hapur me përjashtim të rastit kur parashikohet shprehimisht në statut. Në mbledhjen e Asamblesë mund të paraqitet vetëm një kërkesë për votim të fshehtë, atëherë kur për shkak të numrit të të pranishmëve, ngarkesës së rendit të ditës apo për një shkak tjetër të arsyeshëm, ky lloj votimi rezulton më i përshtatshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Neni 29 E drejta e votës

Çdo anetar i shoqërisë në kohën e ushtrimit të veprimtarisë së Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtën e një vote.

Neni 30 Përfaqësimi në mbledhje

Nëse një anetar nuk merr ose nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, autorizon me prokurë të posaçme një person tjetër të ushtrijë të drejtën e votës.

Neni 31 Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, Asambleja e Përgjithshme merr vendime me më shumë se gjysmën e votave të vlefshme të anetarëve pjesëmarrës.

2. Në rastet e ndryshimit të statutit, pranimi ose largimi të një grupi anetarësh, transformimit, ndarjes, shpërbërjes dhe riaktivizimit të shoqërisë vendimi merret me më shumë se 2/3 e votave të vlefshme.

3. Në statut mund të vendosen shumica më të larta se ato të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, por që në asnjë rast nuk duhet të kalojnë 4/5 e votave të vlefshme.

Neni 32 Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Sekretari përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

2. Formatit dhe elementet e procesverbalit përcaktohen në statut. Procesverbalit i bashkëlidhet lista e anetarëve pjesëmarrës dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

3. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Sekretari, Presidenti dhe dy anetarë në këtë Asamble që nuk janë mbajtës të asnjë posti.

Neni 33 Kundërshtimi i vendimeve

1. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që janë në kundërshtim me këtë ligj, me statutin, ose që dëmtojnë interesat e 2/3 të anetarëve ose të të tretëve, janë të pavlefshme.

2. Procedura dhe rregullimi i pasojave të kundërshtimit përcaktohet në statut.

Neni 34 Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organ kolegjal i cili administron dhe përfaqëson shoqërinë sipas orientimeve të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme dhe jep llogari para saj.

2. Këshilli Drejtues përbëhet nga jo më pak se 3 antarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme ndër anetarët e shoqërisë për një periudhë të caktuar në statut dhe që mund të tërhiqen në çdo kohë prej saj. e Këshillit Drejtues zgjedhin Kryetarin dhe zëvendësin e tij.

3. Statuti mund të parashikojë emërimin si anëtarë të Këshillit Drejtues të personave të kualifikuar dhe ekspertë, që nuk janë anetarë të shoqërisë, me kusht që, numri i tyre të jetë jo më shumë se 1/3 e numrit të anetarëve të Këshillit Drejtues dhe të mos zgjidhen në postet drejtuese të këtij organi.

4. Rregullat dhe kriteret për zgjedhjen e antarëve të Këshillit Drejtues, periudha e veprimtarisë dhe procedura e shkarkimit të tyre përcaktohen në statutin e shoqërisë kooperativiste bujqësore.

Neni 35 Funkcionimi i Këshillit

1. Këshilli Drejtues thirret në mbledhje nga Kryetari ose Zëvendëskryetari jo më pak se një herë në muaj. Kryetari i Këshillit përfaqëson shoqërinë kooperativiste bujqësore në marrëdhënie me të tretët.

2. Mënyra e funksionimit dhe marrja e vendimeve të Këshillit Drejtues, kompetencat e Kryetarit dhe të drejtat e detyrimit e anetarëve të Këshillit parashikohen në statutin e shoqërisë.

Neni 36 Këshilli Mbikqyrës

1. Këshilli Mbikqyrës kontrollon veprimtarinë administrative dhe financiare të shoqërisë dhe inspekton e verifikon të gjithë dokumentacionin e shoqërisë.

2. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 anetarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme ndër anetarët e shoqërisë, për një periudhë të caktuar në statut. Statuti mund të parashikojë emërimin si anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të personave të kualifikuar dhe ekspertë, që nuk janë anetarë të shoqërisë, me kusht që, numri i tyre të jetë jo më shumë se 1/3 e numrit të anetarëve të Këshillit Mbikqyrës. Rregullat dhe kriteret e përzgjedhjes së antarëve dhe detyrat e tyre përcaktohen në statut.

3. Zëvendësimi i anetarëve të Këshillit Mbikqyrës, para përfundimit të periudhës kohore për të cilën janë zgjedhur, bëhet nga Asambleja e Përgjithshme me 3/4 e votave të anetarëve të pranishëm.

4. Anetarët e Këshillit Mbikqyrës nuk lejohen që në të njëjtën kohë të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues.

5. Këshilli Mbikqyrës paraqet raport për drejtimin e veprimtarisë ekonomike e financiare të shoqërisë sa herë që kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme, ose mund të thërrasë Asamblenë për çdo problem të rëndësishëm që vlerëson se duhet diskutuar.

6. Këshilli Mbikqyrës mund të kërkojë në çdo kohë raport nga Këshilli Drejtues për veprimtarinë e tij dhe të verifikojë vetë ose nëpërmjet anetarëve të tjerë dokumentet e shoqërisë. Për shkeljet e konstatuara Këshilli Mbikqyrës mund të pezullojë anetarët e Këshillit Drejtues deri në një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 37 Raporti i llogarive vjetore

Raporti i menaxhimit të llogarive vjetore paraqitet për miratim në Asamblenë e Përgjithshme. Raporti përfundimtar vihet në dispozicion të Këshillit Drejtues brenda 10 ditëve nga afati përfundimtar i dorëzimit të llogarive.

Neni 38 Shpërblimi

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe të Këshillit Mbikqyrës që nuk janë anetarë të shoqërisë shpërblehen për punën e kryer.

2. Kriteret për dhënien e shpërblimit përcaktohen në statut.

Neni 39 Përgjegjësia e anetarëve të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës

Anetaret e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës gjatë ushtrimit të funksioneve mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara në shoqëri, në përputhje me parashikimet statutores dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 40 Komiteti i Apelit

1. Komiteti i Apelit është organi që shqyrton rastet e procedimeve të parashikuara në nënet 17 dhe 21 të këtij ligji.
2. Procedura e përzgjedhjes së anetarëve, kohëzgjatja e ushtrimit të detyrave dhe mënyra e funksionimit të Komitetit përcaktohen në statut.

KREU VI

REGJIMI EKONOMIK

Neni 41 Kapitali shoqëror

1. Kapitali i shoqërisë kooperativiste bujqësore përbëhet nga kontributet e anetarëve të cilat mund të jenë në natyrë, pasuri të luajtshme / të paluajtshme, të konvertuara në vlerë monetare në momentin e depozitimit.

2. Kapitali minimal për krijimin e shoqërisë kooperativiste bujqësore është 3 milion leke, 25% e se ciles derdhen në momentin e regjistrimit dhe pjesa tjetër në periudhë të ardhshme, me përjashtim të rasteve kur statuti përcakton një periudhë me të kufizuar.

Neni 42 Kontributet e detyrueshme

1. Kontributi i detyrueshëm minimal përcaktohet në statutin e shoqërisë kooperativiste bujqësore dhe është i ndryshëm për gjitha klasat e anetarëve. Forma e dhënies së kontributeve të detyrueshme në kapitalin e shoqërisë nga secili anetar, norma dhe afati kohor i derdhjes përcaktohet në statut.

2. Anetaret e rinj të shoqërisë shlyejnë kontributin e detyrueshëm në kapitalin e shoqërisë, i cili ndryshon në funksion të formave të caktuara në pikën 2 të nenit 41 të këtij ligji.

3. Në statut përcaktohet gjithashtu masa e interesit që perfitojnë anetaret për pjesën e kapitalit të derdhur prej tyre.

Neni 43 Ndryshimi i kapitalit

1. Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit si dhe prekja e rezervave të shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

2. Zvogëlimi i kontributeve të detyrueshme të anetarëve në proporcion me sasinë të kontributit të detyrueshëm minimal të kërkueshëm për çdo tip anetari në momentin e marrjes së vendimit.

3. Zvogëlimi i kapitalit nuk mund të jetë më i vogël se kapitali minimal i përcaktuar në pikën 3 të nenit 41 të këtij ligji.

Neni 44 Transferimi i aksioneve

1. Aksionet u transferohen:

- a) anetarëve të shoqërisë,
- b) trashëgimtarëve kur kërkojnë të jenë anetar.

2. Transferimi i aksioneve tek trashëgimtarët që kërkojnë të jenë anetarë, bëhet brenda gjashtë muajve nga vdekja e anetarit. Në rastet kur nuk përmbushet kushti i mësipërm, trashëgimtarët kanë të drejtë të kërkojnë likuidimin e kontributit përkatës.

Neni 45 Rimbursimi i kontributeve

1. Anetaret që largohen nga shoqëria rimbursohen për kontributet e derdhura në kapital.

2. Rimbursimi i kontributeve bëhet sipas bilancit përmbyllës të vitit ekonomik, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet nga momenti i largimit të anetarit.

2. Statuti parashikon mënyrën dhe procedurën e rimbursimit të kontributeve.

Neni 46 Fondi i rezervës së detyrueshme

1. Fondi i rezervës së detyrueshme destinohet për konsolidimin, zhvillimin dhe garancinë e shoqërisë kooperativiste bujqësore dhe është i pandashëm midis anetarëve.

2. Në fondin e rezervës së detyrueshme do të depozitohen:

- a) një pjesë e fitimeve të veprimtarisë së shoqërisë që përcaktohen me statut.
- b) një pjesë e kapitalit të anetarëve që largohen në mënyrë të pajustificuar nga shoqëria.,
- c) kuotat e pranimit të anetarëve të rinj.

Neni 47 Fondi i edukimit, formimit profesional dhe promovimit

1. Shoqëria krijon fondin e edukimit, formimit profesional dhe promovimit që shërben për të përmbushur objektivat e mëposhteme:

- a) trainimi dhe formimi profesional
- b) nxitja dhe përhapja e modelit kooperativist dhe promovimi i bashkepunimit
- c) promovimi kulturor, profesional dhe ndihmes i komunitetit si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së tyre.
- d) veprimtari për mbrojtjen e mjedisit
- e) promovimin e barazisë gjinore

2. Fondi i edukimit është i pandashëm midis anetarëve.

Përbërja e fondit, masa, dhe mënyra e përdorimit të tij përcaktohen në statut.

Neni 48 Viti ekonomik dhe përcaktimi i përfitimeve

1. Viti ekonomik zgjat dymbëdhjetë muaj sipas vitit fiskal, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe atij kontabel në fuqi.
2. Përcaktimi i fitimeve të vitit ekonomik realizohet në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 49 Përdorimi i fitimeve

1. Shoqëria kooperativiste bujqësore, parashikon depozitim në fondin e rezervës së detyrueshme të një pjese të fitimeve të llogaritura nga diferenca e përfitimit nga veprimtaritë e shoqërisë kooperativiste bujqësore me humbjet e çdo lloji natyre nga vitet e mëparshme ekonomike.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme vendos masën dhe formën e përdorimit të përfitimeve nga veprimtaritë kooperativiste bujqësore për shpërblimin e anetarëve.
3. Në statut përcaktohet përqindja e fitimeve që investohen në kapitalin e shoqërisë si dhe përqindja që depozitohet në fondin e edukimit, formimit profesional dhe promovimit.

Neni 50 Faturimi i humbjeve

1. Faturimi i humbjeve realizohet nga një llogari e veçantë e shoqërisë kooperativiste bujqësore.
2. Statuti i shoqërisë cakton mënyrën, kriteret dhe rregullat për shlyerjen e humbjeve, të cilat nuk e tejkalojnë periudhën prej shtatë vjetësh.

KREU VII

DOKUMENTACIONI DHE KONTABILITETI

Neni 51 Dokumentacioni i shoqërisë

1. Shoqëria kooperativiste bujqësore mban të dhënat e veprimtarisë në:
 - a. regjistrin e anetarëve;
 - b. regjistrin e kontributeve të kapitalit;
 - c. regjistrin e akteve të organeve të saj dhe të likujduesve;
 - ç. regjistrin e inventarëve dhe llogarive vjetore;
 - d. si dhe regjistrat për akte të tjera financiare dhe kontabile.
2. Regjistrat e shoqërisë janë nën përgjegjësinë e Këshillit Drejtues, që i arkivon për një periudhë prej gjashtë vjetësh, nga transkriptimi të aktit ose marrëveshjes së fundit, ose nga heqja e të drejtave apo detyrimeve që përcaktojnë.

Neni 52 Kontabiliteti dhe llogaritë vjetore

Shoqëria kooperativiste bujqësore mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

KREU VIII

FORMA TË TJERA TË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SHOQËRISË KOOPERATIVISTE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE

Neni 53 Shkrija, ndarja, transformimi, shpërbërja dhe likuidimi

Shkrija, ndarja, transformimi, shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë kooperativiste bujqësore bëhet sipas procedurave për shoqëritë aksionere (S.H.A.), në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 54 Federatat e shoqërive kooperativiste bujqësore

1. Shoqëritë kooperativiste bujqësore të nivelit të parë dhe të dytë mund të bashkohen në konfederata për të mbrojtur dhe promovuar interesat e tyre.
2. Për themelimin dhe funksionimin e një Konfederate duhet të bashkohen të paktën tre shoqëri kooperativiste bujqësore.
3. Organet e Konfederatës janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme dhe
 - b) Këshilli Drejtues.
4. Përbërja, numri, procedurat e funksionimit dhe të organizimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Drejtues të Konfederatës përcaktohen në statut.
5. Konfederata kryen këto detyra:
 - a) mbron interesat e përgjithshme të shoqërive;
 - b) nxit promovimin, krijimin dhe bashkimin e shoqërive kooperativiste bujqësore;
 - c) zgjidh konfliktet midis shoqërive përbërëse;
 - ç) ndërmjetëson dhe përfaqëson shoqëritë me organizatat dhe institucionet shtetërore.
4. Konfederata fiton statusin e personit juridik, pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Dokumenti publik për themelimin duhet të përmbajë:
 - a) listën e shoqërive;
 - b) aktin e marrëveshjes për themelimin;
 - c) organet përfaqësuese dhe drejtuese;
 - ç) emërtimin;
 - d) statutin.

5. Statuti përfshin elementet e mëposhtme:

- a) emërtimin e Konfederatës;
- b) adresën dhe shtrirjen territoriale;
- c) kushtet dhe procedurat për përfitimin dhe humbjen e statutit;
- ç) përbërjen, funksionimin dhe zgjedhjen e organeve të saj të përfaqësimit dhe menaxhimit.

Neni 55 Forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik.

1. Shoqëria kooperativiste bujqësore, ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe kontrata, me persona fizikë ose juridikë, publike ose private, për përmbushjen e qëllimit të shoqërisë.

2. Fitimet e marrëveshjeve dhe kontratave kalojnë tërësisht në fondin e rezervës së detyrueshme të shoqërisë kooperativiste bujqësore.

Neni 56 Nxitja e kooperativizmit

Shoqëria kooperativiste bujqësore është subjekt i tatueshëm. Ajo përjashtohet nga tatimet për 5 vitet e para të veprimtarisë, si dhe për vitet e ardhshme paguan vetëm ½ e tatimeve. Shoqëria kooperativiste bujqësore përfiton mbështetje shtetërore në përputhje me kriteret e parashikuara në ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 57 Transformimi i shoqatave të fermerëve dhe shoqërive të bashkëpunimit reciprok bujqësor

1. Shoqatat e fermerëve që janë krijuar në bazë të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, si dhe shoqëritë e bashkëpunimit reciprok bujqësor të krijuara në bazë të ligjit nr. 8088, datë 21.03.1996 "Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok", i ndryshuar, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, transformohen në shoqëri kooperativiste bujqësore, sipas këtij ligji, pa kërkesa të vecanta.

2. Organi ekzekutiv i OJF-se apo keshilli administrativ i SHBR-se duhet të hartojë një projekt transferimi dhe një relacion shpjegues të aspekteve juridike dhe ekonomike të këtij transferimi si dhe pasojave që do të kenë anëtarët dhe të punësuarit.

3. Mbledhja e përgjithshme e OJF-se apo Ansambleja e Përgjithshme e SHBR miraton projektin e transferimit dhe statutin e ri të shoqërisë kooperativiste si dhe ben regjistrimin në QKR, brenda tremuajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sic përcaktohet në pikën 1 të këtij neni.

Neni 58

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8088, datë 21.03.1996, "Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok", i ndryshuar, nuk është më i aplikueshëm për fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.

Neni 59 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare